



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIVJAKE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCES

Nr. 9742 / 3 Prot

Divjakë, më. 15 / 09 / 2025

PROJEKT - VENDIM
Nr. 62 Datë, 15 / 09/2025

“PËR MIRATIMIN E NJË RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2025”

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 139/2015, date 07/12/2015 “Per veteqeverisjen vendore” neni 54 pika dh, ligjin nr.68/2017 dt.27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore” neni 44, ligjin 9936 dt. 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise” (i ndryshuar), Udhezimin nr.9 dt.20.03.2018 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit" pika 100 gërma a.- VKB. nr.65 datë 24.12.2024 “Mbi miratimin e PBA 2025-2027, Buxhetit të vitit 2025, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërrmarjet vartëse të Bashkisë për vitin 2025”, VKB. Nr. 12, date 24.02.2025 “Per miratimin e nje shtese ne buxhetin e vitit 2025 nga te ardhurat e trasheguara nga viti 2024”, ne ligjin 115/2024, “Per buxhetin e vitit 2025”

I Propozojmë Këshillit të Bashkisë Divjake që në mbledhjen e datës 26/09/2025:

-Të Miratojë një rishperndarje fondesh nga programi 09120 (Arsimi parashkollor), programi 04520 (Rrugët Rurale), si dhe nga zëri “të tjera” llogaria 602, programi 01110 ne zerin “Investime” llogaria 231, programi 01110 (Bashkia Divjakë) sipas pasqyrave më poshtë:

I-Të Pakesohen fondet sipas, kodit të institucionit, kapitujve, programeve dhe llogarive sipas tabelës:

Enti Qeverisjes	ML	Kodi i Institucionit	Kap	Emertimi	Programi	Ll.Ekonomike	Kodi Projekti	Vlera në lekë
147	00	2147001	01	Arsimi parashkollor, ndertim kende lojrash	09120	2310000	1470197, 1470198,1470199, 1470200,1470201	12.500.000
147	00	2147001	05	Blerje binderi per shtrimin e rrugeve urbane Bashkia Divjake,	04520	2310000	1470121	3.371.032

147	00	2147001	01	Te tjera	01110	6020000	9999999	74.528
Totali								15.945.560

Të shtohen fondet sipas, kodit të institucionit, kapitujve, programeve dhe llogarive sipas tabelës:

Enti Qeverisjes	M L	Kodi i Institucionit	Kap	Emertimi	Programi	Ll.Ekonomike	Kodi Projekti	Vlera në lekë
147	00	2147001	01	Planifikim,Menaxhim Administrim	01110	231	1470186	14.925.560
147	00	2147001	01	Planifikim,Menaxhim Administrim	01110	231		900.000
147	00	2147001	01	Planifikim,Menaxhim Administrim	01110	231		120.000
Totali								15.945.560

Ky fond do të përdoret:

1.Si shtesë sipas projektit, për investimin “Linja e kanalizimeve te ujrave te zeza dhe shtesë impjanti për trajtimin e ujrave të zeza Divjakë” per vleren 14.925.560 leke

2.Per Mbikqyrje punimesh per Investimin “Linja e kanalizimit e ujrave te zeza dhe shtesa impjanti, Bashkia Divjake per vleren 900.000 leke

3. Per Kolaudim punimesh per Investimin “Linja e kanalizimit e ujrave te zeza dhe shtesa impjanti, Bashkia Divjake” per vleren 120.000 leke

Fodi me vlerë 15.945.560 lekë që kërkojmë të transferohet në këtë projekt ishte parashikuar në buxhetin e vitit 2025 si me poshte;

a)Për ndërtimin e këndit të lojrave në 4 Njësite Administrative dhe në Divjakë më vlerë totale 12.500.000 lekë, si më poshtë;

nr.	progr.	kod proj	Emertimi I projektit /investimit	te ardh. Te trasheg. Nga transf. sektoriale
1	09120	1470197	Permiresim I kendit te lojerve ne Njesine Administrative Divjake	2,500,000
2	09120	1470198	Ndertim kend lojerash ne Njesine Administrative Terbuf(Cerme Sektor)	2,500,000
3	09120	1470199	Ndertim kend lojerash ne Njesine Administrative Grabian(Grabian)	2,500,000
4	09120	1470200	Ndertim kend lojerash ne Njesine Administrative Gradishte(Kemishtaj)	2,500,000
5	09120	1470201	Ndertim kend lojerash ne Njesine Administrative Remas(Remas)	2,500,000

shuma	12.500.000
-------	------------

b) Për blerje binderi për shtrimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjakë", kontrata 2858/19, date 18.02.2024, projekti me kod. 1470121, i cili është parashikuar në Buxhetin e vitit 2025 për tu likuiduar nga të ardhurat e Bashkisë Divjakë në vlerën 5.000.000 lekë. Por pas hartimit të Buxhetit të Bashkisë Divjakë i cili kishte marrë formën përfundimtare dhe ishte dërguar për shqyrtim në Këshillin e Bashkisë Divjakë, nga MFE vjen fondi për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe kjo vlerë e parashikuar në Buxhet është likuiduar nga fondi i detyrimeve të prapambetura. Fondi i përdorur nga kjo kontratë është me vlerë **3.371.032 leke**. I cili do të përdoret si shtesë fondi për këtë projekt.

c) Për zërin "Të tjera" program 01110, grupi 00, kapitulli 01, llogaria 602, vlera 74.528 lekë.

Për Sektorin Juridik

Andi BULLARI

Për Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Ardit Janko

Për Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës

Xheladin BRAHKOLA

KRYETARI

Josif GORREA

